



Raport nga procesi i konsultimit publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për Tregun Tërëditor në Istog

Komuna e Istogut ka organizuar konsultim publik me qytetarë dhe palë të interesuara lidhur me Draft-Rregulloren për Tregun Tërëditor në Istog, me qëllim të rregullimit të funksionimit të tregut, krijimit të kushteve të përshtatshme për tregtarët dhe garantimit të rendit dhe higjienës për qytetarët.

Draft-rregullorja është hartuar për të përcaktuar rregullat për shfrytëzimin e hapësirës së tregut, orarin e punës, kushtet sanitare, obligimet e tregtarëve dhe kompetencat e komunës në menaxhimin e tregut. Dokumenti është publikuar paraprakisht në uebfaqen zyrtare të Komunës së Istogut dhe ka qenë i hapur për komente nga publiku.

Gjatë konsultimit publik, përfaqësuesit komunalë prezantuan përmbajtjen e draft-rregullores dhe arsyetimin për nevojën e rregullimit të tregut të tërëditor, duke theksuar rëndësinë e krijimit të një ambienti të sigurt dhe funksional për zhvillimin e aktiviteteve tregtare.

Qytetarët dhe tregtarët pjesëmarrës shprehën mendime dhe sugjerime lidhur me orarin e funksionimit të tregut, ndarjen e hapësirave sipas llojit të aktivitetit, përmirësimin e kushteve higjienike dhe rritjen e mbikëqyrjes institucionale. U theksua gjithashtu nevoja për trajtim të barabartë të të gjithë tregtarëve dhe përmirësim të infrastrukturës së tregut.

Të gjitha komentet dhe sugjerimet e paraqitura gjatë konsultimit janë evidentuar dhe do të shqyrtohen nga drejtoria përgjegjëse gjatë finalizimit të Draft-Rregullores.

METODAT E KONSULTIMIT

Publikimi i draft-rregullores në uebfaqe, konsultim publik me qytetarë, pranimi i komenteve me shkrim.

PËRFUNDIM

Procesi i konsultimit publik ka kontribuar në përmirësimin e draft-rregullores dhe në krijimin e një kuadri rregullativ më të qartë për funksionimin e tregut të tërëditor në Istog.